

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E OBILIT-OPŠTINA OBILIÇ DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE			
Pranuar/Prisajecë: 19.06.2020			
Nr. Organizative	Nr.	Shtetësi	Vendi
Org. Jedinica II	Br.	Republika e Kosovës	Kosova



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo  
 Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike  
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave  
 Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/  
 Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZHBENI MEMORANDUM**  
**OFFICIAL MEMORANDUM**

**PËR: Z.Burim GËRGURI**  
 Kryesues i Kuvendit Komunal Obiliq

**DATA: 16.06.2020**

**PERMES: Z.Xhafer GASHI**  
 Kryetar i Komunës Obiliq

**Z.Arben BERISHA**  
 Drejtor i DPUPK-së

**REFERENCA: 04/1-010/112/2020**

**PREJ: Kapiten Sejdi ZEQRIRI**  
 Komandant i Stacionit Policor Obiliq

**LENDË: KËRKESË**

Të nderuar,

Fillimisht dua të ju falenderoj për përkrahjen e vazhdueshme që keni bërë dhe jeni duke bërë për Stacionin Policor në Obiliq, sidomos në këtë kohë Pandemie nga Covid-19, për dezinfektimin e stacionit **tri herë për tre muaj**, si dhe furnizimin me **Maska dhe Dorëza** mbrojtëse, duke mos na anashkaluar asnjëherë dhe llogaritur si pjesë e familjës së Institucioneve Komunale, gjë që na bënë të ndjehemi të privilegjuar në kontributin dhe respektin reciprok që jeni duke treguar vazhdimisht.

Tani më që janë duke u zhvilluar punimet në sheshin e qytetit para Stacionit Policor, neve na është pamundësuar hyrja dhe dalja, e sidomos shfrytëzimi i **Parkingut të veturave të Zyrtarve Policor, i cili tani është pjesë e sheshit**. Prandaj për momentin jemi duke e shfrytëzuar rrugën dytësore deri në zgjidhjen e problemit të një alternative tjetër.

Zyrtarët Policor për shkak të Etikës nuk mund t'i parkojnë veturat në trotoare apo rrugica të qytetit, ndërsa të njëjtit zyrtar t'i gjobisin qytetarët për të njëjtat veprime.

Andaj pasi që një kohë kemi mbetur pa parking, kërkojmë që të na mundësoni një hapësirë e cila gjendet mu para objektit të Stacionit Policor, e cila për momentin nuk është duke u shfrytëzuar nga askush dhe të njejtën ta legjitimoni dhe aftësoni për parking i cili do të përdoret vetëm për veturat e zyrtarëve policor.

Parcela e cila gjendet përballë objektit të Stacionit Policorë është me dy numra në kadastër 1. **Nr 01869-0** dhe 2. **Nr 01870-0**, parcela të cilat janë me gropa dhe nuk mund të shfrytëzohen racionalisht.

Prandaj me miratimin nga ana e Kuvendit Komunal, shpresoj që të na dilni në ndihmë edhe me rregullimin e terrenit të përshtatshëm për parking dhe shfrytëzim sa më racional.

Trajtimi i kësaj kërkesë do të ndikonte pozitivisht në motivimin e zyrtarëve policor për përkushtimin ndaj detyrës për të cilën janë të thirrur në zbatim të ligjit, dhe nuk do tu sillte ngarkesë për gjetje të vendparkingjeve dhe keqkuptimeve apo keqinterpretimeve që do të bëheshin nga qytetarët.

Mbesim me shpresë dhe të mirëkuptuar në zgjedhjen e këtij problemi i cili është duke na preokupuar të gjithë stafin, duke shpresuar dhe besuar se kërkesa jonë do të trajtohet me urgjencë, si dhe do të gjejë mirëkuptimin në zgjedhjen e këtij problemi mjaft shqetësues nga ana jonë.

Me respekt duke ju uruar suksese dhe punë të mbarë .

Paraprkisht ju jam mirënjohës për bashkëpunimin tuaj !

*Kapiten: Sejdi ZEQRIRI*  
*Komandant i St. Pol. Obiliq*  
*Tel: 045-122-007 / Zyre -2102*  
*sejdi.zeqiri@kosovopolice.com*



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtoreti/Njesia  
Kryesuesi i Kuvendit

Data 19/06/2020

I.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri  
Ministrija e punve te Brendshme  
Adresa e vendbanimit  
Obiliq  
Numri i tel. fiks Numri i tel. mobil

Numri personal  
00000000000  
E-mail Adresa

2. Mënyra e pranimi  
Memorandum  
Statusi i lëndës  
Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-070/05-0010831/20

Afati i zgjedhjes

19/07/2020

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Memorandum

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Ministrija e punve te  
Brendshme vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: sala.paci